
PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

e RAPORTIT te VNM se Thelluar

OBJEKTI

“ Shfrytezim guri gelqeror me karriere “

VENDNDODHJA

Qaf Thane, Njesia administrative Rrajce, Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan

SUBJEKTI

Shoqeria “ KROMOLLARI “ sh.p.k

SHKURT 2020

PERMBAJTJA E LENDES

1. HYRJE

Emertimi dhe te dhenat e objektit minerar

2. LEGJISLACIONI MJEDISOR

2.1 Kuadri ligjor mjedisor

2.2 Metodologjia e vleresimit mjedisor

3. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

3.1 Vendndodhja

3.2 Aktiviteti qe zhvillohet

3.3 Perdorimi i energjise dhe lendeve te para

3.4 Lidhja me infrastrukturen dhe planet e zhvillimit

3.5 Mbrojtja nga zjarri

3.6 Menaxhimi i mbetjeve te ngurta

4. VLERESIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS DHE MASAT PARANDALUESE

4.1 Vleresimi i ndikimeve kryesore ne mjedis

4.2 Ndikimet nderkufitare

4.3 Masat parandaluese per minimizimin e ndikimeve negative ne mjedis

4.4 Kohezgjatja e ndikimeve ne mjedisin e zones

4.5 Siperfaqja e shtrirjes se ndikimit ne mjedis

5. MONITORIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE AKTIVITETIT MINERAR

6. KONKLUZIONE E REKOMANDIME PER PROJEKTIN e PROPOZUAR

1. HYRJE

Emertimi dhe te dhenat e objektit minerar

Ky raport i thelluar i projektit te propozuar, hartohet me kerkese te subjektit “**Kromollari**” **Sh.p.k.** me NIPT: K64020601H, me seli ne Korce Bucimas BUCIMAS, vende te tjera te ushtrimit te aktivitetit Elbasan,Rrajcë,Urakë, Qafë Thanë, me administrator **Z. Mariglen Kromollari**.

Ky subjekt, eshte pajisur nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë(MEI), Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik për Minierat dhe Industrinë me Aktin e Miratimit Nr.771/1, për lejen minerare të shfrytëzimit me numër çështje LC-2505-12-2013 datë 06.01.2014, dorëzuar nga Subjekti "Kromollari" Sh.p.k. për shtyrje të afatit të lejes minerare të shfrytëzimit Nr.771 datë 28.06.2004, zoteruar nga ana subjektit "Kromollari" Sh.p.k.(leje e meparshme) për mineralin gur gëlqeror që bënë pjesë në grupin e mineraleve ndërtimor për objektin " Qafe - Thane", rrethi Librazhd , Qarku Elbasan. Ky Akt Miratimi është lëshuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë(MEI), me shkresën Nr.3480 Prot. Tiranë më 3/12/2014 Objekti i vleresimit te ketij raporti te thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis eshte aktiviteti i punimeve te shfrytezimit te gurit gelqeror nga ky subjekt ne nje siperfaqe totale te miratuar prej 2.6 Ha. Emertimi i aktivitetit eshte: Shfrytezim guri gelqeror ne objektin “Qafë Thanë”, rrethi Librazhd,Qarku Elbasan.

Objekti i aktivitetit

Objekti i aktivitetit eshte shfrytezimi i gurit gelqeror me karriere ne nje siperfaqe prej 2.6 ha dhe nje sasi rezervash gjeogjike te nxjerreshme rreth 591 450 m³me permbajtje 53.4 % CaO, te cilat ndodhen ne qaf Thane, njesia administrative rrajce, Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan. Ne projektin e shfrytezimit te hartuar per kete objekt minerar eshte parashikuar:

- Shfrytezim i objektit minerar me karriere nga kuota + 1058 m deri ne kuoten 865 m.
- Rezervat e nxjerreshme te gelqerorit 591 450 m³
- Gelqerori qe perfitohet nga procesi teknologjik i shfrytezimit, mund te perdoren nga subjekti KROMOLLARI, per te prodhuar blloqe gelqerori dekorativ dhe nga mbetjet gelqerore te prodhohen ne Impiantin e thyerjes e fraksionimit, materiale inerte si : rere, granil, stabilizant, cakull, gure etj.

2. Legjislacioni mjedisor

2.1. Kuadri ligjor mjedisor dhe institucional qe lidhet me projektin;

Pergatitja e Raportit te thelluar te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis te aktivitetit te propozuar, shfrytezim te gurit gelqeror me karriere, eshte kryer duke u bazuar ne aktet ligjore te meposhteme:

- Ligji nr 10 431 date 09.06.2011 “Per mbrojtjen e Mjedisit” ndryshuar me Ligjin nr 53/ 2020 date 30. 04. 2020
- Ligji nr 10 440 date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”
- Ligji Nr 10 448 date 14.07.2011 “ Per lejet e mjedisit”
- Ligji Nr 10 463 date 22.09.2011 “Per menxhimin e integruar te mbetjeve”
- VKM nr 686, date 29.07.2016 “per miratimin e rregullave, te pergjegjsive e te afateve per zhvillimin e procedures se veresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore”
- Udhezimin 96/61/EEC Komunitetit Europian per mbrojtjen e plote dhe kontrollin e ndotjes.
- Udhezimin Nr 3 date 17.05.2006 te Ministrise se Mjedisit “Per planet e rehabilitimit te siperfaqeve te demtuara nga shfrytezimi siperfaqesor.
- Ligji Nr 10 081, date 23.02. 2009 “ Per licensat, autorizimet dhe lejat ne Republiken e Shqiperise ”, i ndryshuar.
- Ligji Nr 10 266, dt 15.04.2015 “ Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
- VKM nr 435, dt. 12.09.2015 “Per miratimin e normave te shkarkimit ne ajer”

Kërkesa dhe procedura e Vlerësimit të thelluar te Ndikimit në Mjedis, ne zbatim te VKM 686, date 29.07.2016 trajtohet nëpërmjet aplikimit ne Ministrine e Mjedisit dhe mbas Deklarates Mjedisore te firmosur nga Ministri, aplikohet ne QKB per Leje Mjedisore tipi B, dhe mban kodin III.1.C.

Procedura e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ndahet në dy faza : Proçedurë paraprake e VNM-së dhe proçedurë e thelluar e VNM-së. Referuar Ligjit “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”, Shtojca I “ Projektet qe i nenshtrohen procedures se thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis”, pika 19 “ Gurore dhe miniera siperfaqesore ku siperfaqja e vendit eshte mbi 0.5 hektare ”, duke patur parasysh se siperfaqja e kerkuar per shfrytezim nga subjekti KROMOLLARI eshte 0.026 km² ose 2.6 ha, do te ndiqet procedura e thelluar per vleresimin e ndikimit ne mjedis.

2.2 Metodologjia e vleresimit mjedisor

Ky raport i vleresimit te ndikimeve ne mjedis shqyrton dhe analizon natyren dhe fuqine e ndikimeve ne mjedis qe mund te rezultojne nga shfrytezimi i gurit gelqeror, ne Qaf Thane, ne Njesine administrative Rrajce, Bashkia Prrenjjas, Qarku Elbasan dhe propozon masat e nevojshme dhe te domosdoshme per perballimin dhe minimizimin e ndikimeve negative ne mjedis.

Ky studim vleresues pergatitet ne plotesim te kerkesave te percaktuara ne Ligjin nr 10431 date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e Mjedisit", Ligji nr 10440 date 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis" dhe kerkesave e udhezimeve te Ministrise se Mjedisit per vazhdimin e aktiviteteve ekonomike prodhuese ne Republiken e Shqiperise ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Te dhenat qe perdoren ne kete studim dhe qe kane lidhje me shfrytezimin e gurit gelqeror me karriere dhe jane bazuar ne Pojektin gjeollogo minerar te hartuar per marrjen e Lejes se re Minerare si dhe pervojes e eksperiences se deritanishme si dhe ne materialet qe jane hartuar per rinovimet vjetore te Lejeve te Shfrytezimit ne Agjensine Kombetare te Burimeve Natyrore ne Tirane.

Ndersa vleresimi i shkalles dhe ndikimit ne mjedis u be ne baze te rikonjicionit te vendndodhjes se karrieres, njohjes me problematiken e hasur deri me tani gjate shfrytezimit te karrierave, kontrollin e shkarkimeve ne toke, uje dhe ajer, komunikimin dhe konsultimet me banoret e zones, perdorimit te literatures mjedisore per kete qellim dhe eksperiences pozitive te deritanishme gjate ndertimit dhe shfrytezimit te objekteve minerare te ngjashme, ne rajonin Librazhd - Pogradec - Korce. Ky vleresim i ndikimit ne mjedis kryesisht do perqendrohet ne te gjitha problemet negative qe mund te hasen gjate te gjitha fazave qe do te kaloje ky aktivitet, qe nga ajo e shfrytezimit deri ne mbylljen e saj dhe rehabilitimin perfundimtar te siperfaqes se shfrytezuar, si dhe do te rekomandoje masa zbutese e parandaluese per pasojat negative qe mund te shfaqen gjate zhvillimit te ketij aktiviteti.

Qëllimi dhe objektivat e VNM se thelluar

Ky studim i thelluar per vleresimin e ndikimit ne mjedis per projektin e shfrytezimit te gurit gelqeror ne objektin " Qaf Thane " Bashkia Prrerjas eshte kerkuar nga Administratori i shoqerise "Kromollari" shpk, z. Mariglen Kromollari , ne vazhdim te procedurave per tu pajisur me Leje Mjedisore tipi B.

Qellimi i ketij raporti vleresues eshte:

- Te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te veprimeve te propozuara
- Te promovoj zhvillimin miqesor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis.

Objektivat e ketij procesi vleresues per ndikimin ne mjedisin rrethues mund te ndahen ne dy kategori:

- **Objektivi i pare**, drejtperdrejte eshte te informoje procesin e vendim-marrjes duke identifikuar ndikimet e konsiderueshme potenciale ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit te propozuar.
- **Objektivi dyte dhe perfundimtar**, afatgjate eshte te promovoj zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen ne komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt.

Procesi i vleresimit te ndikimit ne mjedis do te realizohet sipas metodikes se meposhtme :

- Njohje me objektin mineral qe eshte ne shfrytezim
- Njohje me procedurat e punes dhe problematiken gjate vazhdimit te aktivitetit per shfrytezimin e gurit gelqeror
- Njohje me projektin e shfrytezimit te objektit mineral
- Funkionimi i objektit per shfrytezimin e gurit gelqeror
- Identifikimi i mbetjeve dhe shkarkimeve ne toke, ajer e uje
- Njohja me masat e marra per trajtimin e mbetjeve sipas natyres se tyre
- Identifikimi si dhe mundesia per permiresimin e mjedisit dhe minimizimin e ndotjeve gjate zhvillimit te ketij aktiviteti mineral.

Permbledhja e keshillimeve me organet e qeverisjes vendore, konsultimet me publikun e organizatat jofitim pruresse per mjedisin perreth objektit mineral dhe mendimet e tyre.

Nje nder kerkesat per plotesimin e dokumentacionit te nevojshem per tu pajisur me Leje Mjedisore tipi B eshte edhe mendimi nga organet e qeverisjes vendore dhe konsultimet me publikun. Ne pergjithesi gjate shfrytezimit te gurit gelqeror me karriere ne Qaf Thane , Leja minerare nr 771 nga subjekti Kromollari, nuk ka pasur ndonje problematike negative ne lidhje me shendetin e banoreve dhe mjedisin perreth. Ky eshte edhe mendimi i specialisteve te pushtetit vendor – Njesia administrative Rrajce, Bashkia Prrrenjas.

Per te eleminuar problematikat qe krijoheshin nga afersia e objektit mineral me rrugen nacionale Tirane – Prrrenjas – Pogradec eshte kerkuar largimi (spostimi) i siperfaqes se shfrytezimit te gurit gelqeror nga rruga nacionale. Mbas kerkeses se subjektit KROMOLLARI dhe plotesimit te dokumentacionit te nevojshem, Ministria e Energjise dhe Infrastruktures miratoi Lejen minerare nr 771/1. Kjo siperfaqe shfrytezimi prej 0.026 km² do te jete objekt i Lejes mjedisore tipi B.

Nga ana teknike, autoret e Projektit dhe specialiste te fushes minerare qe po zbatojne kete projekt, kane percaktuar disa detyra per vazhdimin normal te ketij aktiviteti dhe per te bere disa permiresime te nevojshme teknologjike per te ulur ne minimum ndikimet negative ne mjedis. Me marrjen dhe zbatimin rigoroz te ketyre masave teknike nga subjekti KROMOLLARI do te minimizohen ndikimet negative ne mjedis dhe shendetit ne banoret perreth karrieres (fshatrat jane ne nje largesi te konsiderueshme).

Ky fakt do te theksohet edhe ne konsultimin me publikun qe do organizohen me banoret e fshatrave perreth karrieres nga drejtuesit e shoqerise Kromollari, te cilet mbas caktimit te dates nga AKM Tirane do te shprehen per vazhdimin e aktivitetit te shfrytezimit te gurit gelqeror me karriere ne Qaf Thane Leja Minerare nr 771/1 , ne njesine administrative Rrajce te Bashkise Prrrenjas.

Ne vazhdimesine e aktivitetit, shoqeria KROMOLLARI siguron banoret, se gjate punes ne karriere do te vazhdohet me thellimin e masave zbutese per eleminimin e ndikimeve negative ne mjedisin fizik e jetesor perreth objektit mineral.

Metodika e përdorur për vlerësimin e ndikimeve të mundshme në mjedis

Çdo aktivitet që zhvillohet në mjedis shoqërohet me pasoja dhe ndikime në të, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jonë ka zgjedhur për t'u zhvilluar. Për një vlerësim sa më objektiv të këtyre ndikimeve është e nevojshme që të kuptohet natyra e proceseve përbërëse të çdo aktiviteti, forma e shfaqjes së tyre dhe më analitikiisht pasojat në mjedis për secilin operacion të kryer.

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e veprimtarisë bëhet duke u nisur nga faktorët që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e funksionimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe, mbetjet e gjenerura; të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtme:

- njohja me projektin dhe teknologjinë e propozuar për zhvillimin e tij,
- njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis,
- njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes,
- konsultimi me dokumente ligjorë e administrativë dhe raporte të VNM për veprimtari të njëjta.

Duke analizuar natyrën e të gjithë proceseve dhe format e shfaqjes së tyre, direkte ose indirekte, përcaktohet qartë lloji i ndikimeve:

- Ndikime të kthyeshme në mjedis,
- Ndikime të pakthyeshme në mjedis.

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit ekzistues dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizim e proceseve natyrore dhe rigjenerim të ekosistemit. Duke qenë se veprimtaria në fjalë propozohet të zhvillohet në një kantjer ekzistues, identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis do të bëhet vetëm për fazën e ushtrimit të aktivitetit.

3. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

3.1 Vendndodhja e aktivitetit

Vendndodhja e objektit mineral “ Qaf Thane ”


Objekti ndodhet ne pjesen lindore te fshatit Urakë, 2.5 km ne vije ajrore, ne lindje te ketij fshati. Ky objekt ndodhet ne krahun e djathte te rruges Tirane - Prenjas-Pogradec, rreth 250 m ne vije ajrore large kesaj rruge. Ndodhet ne afersi te ish rruges se vjeter te Qafë-Thanë pa dale tek kthesa e madhe e rruges automobilistike Prrrenjas-Pogradec.

Objekti i lejes minerare te shfrytezimit 771/1 qe zoterohet nga subjekti KROMOLLARI eshte i vendosur ne hartën topografike ne shkallen 1:25,000 me Nomenklature K-34-102-C-c (Prenjasi) dhe sipërfaqja e objektit mineral prej 0.026 km² kufizohet me 7 pika, me koordinatat perkatese, ne hartën topografike te paraqitur me poshte:

Nr. i pikes	Koordinatat	
	X	Y
1	45 47 620	44 66 220
2	45 47 750	44 66 140
3	45 47 780	44 66 220
4	45 47 760	44 66 240
5	45 47 780	44 66 280
6	45 47 720	44 66 400
7	45 47 680	44 66 420



Pamje satelitore nga vendi ku ndodhet objekti mineral “ Qaf Thane”, Prrrenjas, Qarku Elbasan



3. 2 Aktiviteti minerar qe zhvillohet

Proçesi teknologjik i prodhimit te gurit gëlqeror me karriere eshte i thjeshte. Shfrytezimi do te filloje ne kuten + 1058 dhe do te vazhdoje ne drejtim te kuotave +1050,+1040,+1030, +1020, +1010, +1000, +990, +980, +970, +960, +950, +940, +930, +920, +910, +900, +890, +880, +870 dhe +865, qe do te jete kuota me e ulet e shfrytezimit.

Shfrytezimi do te kryhet nga larte poshte duke filluar ne shkallen +1058+1050 dhe duke vazhduar ne shkallet +1050+1040;shkalla+1040+1030;shkalla+1020+1010;shkalla +1010 +1000;shkalla+1000+990;shkalla+990+980;shkalla+980+970;shkalla+970+960; shkalla +960+950; shkalla+950+940; shkalla+940+930; shkalla+930+920; shkalla+920+910; shkalla +910+900; shkalla+900+890; shkalla+890+870 dhe shkalla+870+865 qe do te jete shkalla e fundit e shfrytezimit ne kuotat me te ulta.

Me arritjen e shkalleve ne konturin perfundimtar dhe nxjerjen e rezervave te shkalleve ne kuotat e larta shkalla +1058+1050; shkalla +1050+1040; shkalla +1040+1030;+1511+1500 ato do te fillojne qe te rehabilitohen. Investimet per rehabilitimi e tyre ka dhjete vjete qe paguhet nga subjekti.

Kjo menyre shfrytezimi lejon qe te punohet normalisht dhe te mos kryhen ne menyre te menjehershme investimet per rruge duke mos qene nevoja qe te fillohet direkt ne shkallen me te larte te shfrytezimit.

Meqenese disponohen te dhena te mjaftueshme lidhur me sistemin e çarjeve te shkembinjve monolite, duke gjykuar nga sistemi i çarjeve ne siperfaqe, i cili pritet qe ne kete lloj shkemi te jete me pak te zhvilluar ne thellesi, ne projekt parashikohet shkeputja e shkembinjve monolite ne forme blloqesh me menytrat e meposhtme:

1. Ne fazen fillestare te prerjes se blloqeve jo te rregullt, zona e fillimit te shkalles pas heqjes se shtreses se shkembinjve me çarje, e cila konsiderohet si faze kalimtare, parashikohet te behet shkeputja e tyre:
 - Ne rastin e prezences se çarjeve te dukshme me eskavator duke perdorur koven ose çekiçin e tij;
 - Shkeputja e blloqeve me ane te perdorimit te birave konturuese dhe pykave hidraulike;
2. Ne fazen e kaperximit te zones kalimtare dhe futjes ne zonen e shkembinjve monolite parashikohet te behet shkeputja e blloqeve :
 - Me perdorimin e birave konturuese te bllokut dhe ndares hidraulike ;
 - Me perdorimin e telit te diamantuar per prerjen e nje deri dy faqeve te bllokut, konturimi me bira dhe perdorimi i pykave hidraulike;
 - Me perdorimin e telit te diamantuar per prerjen e te gjitha faqeve te bllokut;

Zbatimi i njerës apo tjetër metode do të varet nga madhësia dhe cilësia e blloqeve të gelqeroreve. Theksojme se në fazën fillestare të zbatimit të projektit do të ishte e rekomandueshme të përdorej shkeputja e blloqeve monolite me anë të birave konturuese të bllokut dhe përdorimit të ndaresave hidraulike ose kova e eskavatorit dhe çekiçi i tij, pasi kjo metode është me kosto të ulët.

Gjithsesi mënyra më e mirë, nga ana teknike dhe ekonomike, e shkeputjes së blloqeve do të ishte ajo e prerjes së dy faqeve me tel të diamatuar dhe e faqeve të tjera me bira konturuese dhe pyka hidraulike. Ngarkimi i gëlqerorit në trajtë blloqesh, në sheshin e shkalleve do të kryhet me eskavator me zinxhira me madhësi kove 2 m³, eskavatori vendoset në sheshin e shkallës së shfrytezimit. Transporti për në destinacionin e kërkuar do të kryhet me automjete të posaçme të cilat do të jenë të mbuluara për të mos lejuar emetim pluhurash. Është parashikuar që 30 % e sasisë që do të nxirret do të jetë për blloqe dekorativ dhe 70% do të jenë mbetje që do të përdoren për prodhimin e inerteve të ndryshme.

Pershkrimi i procesit të shfrytezimit të gurit gelqeror.

Shfrytezimi i këtij vendburimi do të bëhet me qëllim të hapur karriere. Në zgjedhjen e mënyrës së shfrytezimit ka ndikuar me shumë si faktorë që më i rëndësishmi është prania afër sipërfaqes së pakove të gurit gelqeror. Keta gelqerorë ndodhen shumë afër sipërfaqes me një mbulesë të vogël të gelqeroreve të shkatërruar dhe të padobishëm për blloqe për tregun vendas dhe të huaj. Në zgjedhjen e mënyrës së shfrytezimit ushtrojnë ndikimin e tyre faktorët e mëposhtëm:

- Mënyra e transportit të gurit gelqeror.
- Mënyra e transportit të materialit dheror të zbulimit.
- Mënyra e kryerjes së punimeve të prodhimit.
- Mënyra e kryerjes së punimeve të zbulimit.
- Konditat tekniko minerare të shfrytezimit.
- Kushtet e ndodhjes së këtij vendburimi.
- Relievi ku ndodhen vendburimi i gurit gelqeror.
- Kendin e renies.
- Lidhja e vendburimit me rrugën.
- Tipet e pranuar të paisjeve ngarkuese dhe transportuese.

Zgjedhja e mënyrës së shfrytezimit me punime sipërfaqesore ose nëntokesore varet edhe nga shumë faktorë të tjerë:

- Mundësi të mëdha për rritjen e prodhimit.
- Afatet e ndërtimit të karrierës janë disa here më të shkurtra se sa ndërtimi i minierës për të njëjtin prodhueshmeri.
- Nxjerrje më e madhe e sasisë së rezervave që arrijnë 90-97%.
- Konditat e ndodhjes së trupave ose objektit minerar afër sipërfaqes ose jo.
- Kushtet gjeologjike dhe hidrogeologjike të objektit minerar.
- Konditat topografike (relievi).
- Lidhja e objektit minerar me rrugët ekzistuese.
- Lidhja e objektit minerar me impiantet e përpunimit.
- Vëllimi i mbulesës.
- Prodhimtaria vjetore.

- Vetite fiziko-mekanike.
- Tipet e paisjeve shpuese, germuese (ngarkuese) dhe transportuese.
- Afatet kohore te venies ne shfrytezim.

Nisur nga sa pershkruam me siper ky objekt minerar ka kushte shume te mira tekniko-minerare per shfrytezimin me punime siperfaqesore (karriere). Shfrytezimi me punime siperfaqesore ne krahasim me shfrytezimin nentokesor ka shume avantazhe:

- Perdorimi i makinerive dhe paisjeve te fuqishme me tregues e rendiment te larte.
- Perdorimi i makinerive e paisjeve me permassa te medha.
- Siguria e larte ne pune.
- Rendiment me te larte te puntorit ne pune.
- Venia ne shfrytezim me shpejt me investime me te vogla per nje kohe me te shkurter.
- Kostoja e nxjerrjes se mineralit dhe levizja e mbuleses se ulet.

Duke patur parasysh sa me siper dhe kushtet e ketij vendburimi, mund te themi se menyra me e mire dhe me e mundshme e shfrytezimit per zbatim eshte ajo me qiell te hapur karriere. Shfrytezimi eshte parashikuar te kryhet nga larte-poshte duke filluar ne kuoten ku do te mberrije rruga automobilistike +1060. Kjo kuote do te jete +1060 e cila do te jete pika ku do te filloje shkalla +1058+1050. Shfrytezimi do te vazhdoje me teje ne shkallen +1050+1040 duke vazhduar çdo 10 m lartesi shkallele deri ne shkallen +880+870 dhe shkalla +860+865. Shfrytezimi i ketij vendburimi eshte parashikuar te kryhet per 10 vite, meqense aq eshte dhe sasia e rezervave te mineralit te gurit gelqerorte planifikuar ne Cash-Flow e paraqitur ne kohen e konkurimit ku subjekti u shpall fitues. Shfrytezimi per kete periudhe 10 vjeçare eshte parashikuar te kryhet nga kuota +1058 deri ne kuoten +1050 i cili do te jete edhe niveli i me i larte i shfrytezimit. Krahas kryerjes se shrytezimit te pakove te gelqeroreve, do te kryhen punime gjeologjike per vazhdimin e zbulimit te metejsheem te rezervave ne thellesi.

3.3 Perdorimi i energjise dhe lendeve te para

Lende e pare eshte guri gelqeror si burim natyror, i cili do te rrezohet me lende plasese dhe me mjete te mekanizuara per te prodhuar blloqe gelqerori dekorativ. Do prodhohen deri 10 000 ton/vit kapacitet projektuar ne miratimet vjetore ne Agjensine Kombetare te Burimeve Natyrore ne Tirane.

Energjia elektrike nuk perdoret ne kete objekt minerar. Shpimi i birave behet me sonde shpimi vetelevizese ne shkallet e karrieres. Behet edhe shpimi i birave me cekic shpues per prerjen e blloqeve te gelqerorit. Prodhimi i ajrit te komrimuar behet me motokompresor, i cili punon me nafte.

3. 4 Lidhja me infrastrukturen dhe planet e zhvillimit

Ne kete objekt minerar eshte ndertuar edhe infrastruktura e nevojshme rrugore qe ne lejen minerare ekzistuese nr. 771. Eshte bere lidhja me rruge te cakulluar te karrieres me rrugen nationale Prenjas – Pogradec, rruge e cila mirembahet cdo vit nga subjekti KROMOLLARI shpk. Per cdo bllok shfrytezimi behet lidhja me rruge deri tek shkallet e shfrytezimit ne karriere. Siperfaqja e dhene per shfrytezim nuk preket nga planet e zhvillimit ne zone.

Ne procesin teknologjik te shfrytezimit te mineralit nuk perdoret uji. Uji do sillet me autobot dhe do perdoret ne stinen e veres per sperkatje per uljen e nivelit te pluhurave. Ujrat e ndotura, nga shpelarja e materialit shkembor ne karriere nga reshjet atmosferike, do te grumbullohen ne fund te karrieres ne dy gropa te medha dekantuese, ku do precipitoje lenda e ngurte.

3. 5 Mbrojtja nga zjarri

Ne objektin minerar kemi te bejme me material inert qe nuk digjet. Gjate punes per shfrytezimin e mineralit, subjekti “ KROMOLLARI “ duhet te tregoje kujdesin e duhur per motorrat e mjeteve te renda nga mbinxehja, sidomos ne kohen e veres, sepse behen burim zjarri.

3. 6 Menaxhimi i mbetjeve te ngurta

Ne Projektin e shfrytezimit te gurit gelqeror me karriere hartuar nga specialiste te fushes gjeologjike - minerare eshte parashikuar grumbullimi i mbetjeve te ngurta ne nje cep te karrieres per cdo bllok shfrytezimi dhe perdorimi i tyre me pas per rehabilitimin progresiv e perfundimtar te zones se shfrytezimit. Mbetjet qe do krijohen ne shkallet e karrieres gjate shfrytezimit, grumbullohen dhe do te perdoren per rehabilitimin progresiv dhe perfundimtar te mjedisit ne karriere, gjate dhe mbas perfundimit te shfrytezimit.

- Gjate shfrytezimit perfundimtar te objektit minerar do grumbullohen e depozitohen rreth 22 500 m³ sterile, te cilet perfaqesohen nga shkembinj te mbuleses dhe toka fertile. Pjesa me e madhe e ketyre sterileve do te kthehen perseri ne zonen e shfrytezuar per te bere te mundur rehabilitimin e siperfaqes se shfrytezuar dhe nje pjese per cakullimin e rrugëve auto rurale.
- Hapja e kesaj karriere nuk do te shkaktojë ndonje lloj degradimi fizik pasi zona e shfrytezuar do te rehabilitohet duke e mbushur me mbetjet e karrieres, me toke vegjetale qe do grumbullohet nga zbulimi i mineralit nga guri gelqeror dhe duke mbjelle ne te barera, shkurre e fidana pyjore, mbase edhe pse jo, dru frutore.
- Zonat e banuara jane larg e nuk ndikohen nga kryerja e aktivitetit minerar pasi siperfaqja e dhene per shfrytezim eshte toke kryesisht shkembore dhe e pafruteshme dhe nuk ndikon ne prodhimtarine e zones.

4.VLERESIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS DHE MASAT PARANDALUESE

4. 1 . Vleresimi i ndikimeve kryesore ne mjedis

Veprimtaria minerare propozohet të zhvillohet në një kantjer ekzistues te shfrytezimit te gurit gelqeror. Kjo do të thotë që e gjithë infrastruktura e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit është përgatitur dhe zbatimi i projektit do të shoqërohet vetem me ndikime të tilla siç janë: ndryshimi i destinacionit të përdorimit të tokës apo dëmtim vegjetacioni dhe pejsazhit.

Zona e propozuar per shfrytezimin e gurit gelqeror është relativisht larg fshatit Urake, pra e distancuar nga qendrat e banimit dhe per pasoje karakterizohet nga nje trafik shume i kufizuar dhe prezence e reduktuar e veprimtarise prodhuese e njerezore. Ne objektin minerar do vihen re pluhura (lënda e grimtuar) nga proceset e prodhimit, ngarkimit e transportit te gureve te gelqerorit , gazra e tymra nga qarkullimi i automjeteve, aktivitetet bujqësore e pyjore ne zonen perreth objektit (megjithese shume te pakta)etj.

Objekti ku kryhet veprimtaria minerare është nje objekt i hapur karriere.

Pikat e shkarkimit ne ajer do te jene pikat dhe vendet ku do te kryhen proceset e punes :

- Proçesi i zbulimit te shkembit gelqeror nga mbulesa e dheut
- Proçesi i ngarkimit te sterilit ne frontet e zbulimit.
- Proçesi i ngarkimit te blloqeve te gurit gelqeror ne shkalle.
- Proçesi i rehabilitimit te hapësirës se shfrytezuar.

Te gjitha keto proçese kryhen ne territorin e karrieres ku zhvillohet edhe veprimtaria minerare.

Ndikimet e mundshme në mjedis të veprimtarisë mund të identifikohen sipas fazave nëpër të cilat do të kalojë procesi i shfrytezimit te gurit gelqeror, përkatësisht:

- Zbulimi i blloqeve gelqerore nga mbulesa e deluviale ne shkallet e karrieres
- Transporti dhe grumbullimi i dheut te mbuleses se gelqeroreve, ne nje vend te percaktuar ne Projektin e Shfrytezimit brenda territorit te karrieres per tu perdorur me pas ne procesin e rehabilitimit te saj .
- Ngarkimi e Transporti i blloqeve gelqerore per ne destinacion per perpunim te metejshem

a) Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis gjatë zbulimit te blloqeve gelqerore nga mbulesa dherore ne shkallet e karrieres

- Gjenerim i një sasie pluhuri gjate zbulimit te blloqeve gelqerore nga mbulesa dherore ne shkallet e karrieres, ndikim i cili do të jetë më i ndjeshëm në stinën e thatë
- Gjenerim në ajër i sasive të caktuara të gazeve të djegies te lendes plasese dhe te naftes COx, NOx dhe SOx

- Shqetësim i shtresave të tokës dhe ngjeshje e saj, vibrime; nga germimet me eskavator dhe me matrapikun e eskavatorit.

b) Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis gjatë transportit mbuleses dherore për tek vendi i caktuar në Projekt për tu grumbulluar e përdorur me pas për rehabilitim

Gjatë transportit të mbetjeve të dheut për në venddepozitim brenda sipërfaqes të dhene për shfrytëzim si dhe transporti nga këtu për në shkallet e shfrytëzimit të perfunduara, për të bërë rehabilitimin e tyre; do të ketë ndikime të mundshme negative:

- Gjenerim i një sasive pluhuri gjatë ngarkimit të transportit të mbuleses dherore, ndikim i cili do të jetë më i ndjeshëm në stinën e thatë
- Gjenerim në ajër i sasive të caktuara të gazeve të djegies së lëndës plastike dhe naftes (në motoret me djegie të brendshme) CO_x, NO_x dhe SO_x
- Shqetësim i shtresave të tokës dhe ngjeshje e saj, vibrime, demtim i vegetacionit përreth karrieres
- Ndotje e mundshme e tokës si pasojë e avarive të mekanikës të cilat mund të bëhen shkak për rrjedhje të lubrifikantësh dhe karburantësh.
- Ndotje e mundshme e ujërave sipërfaqësore dhe për shkak të shpëlarjes së gurit gelqeror nën veprimin e reshjeve atmosferike.

c) Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis gjatë ngarkimit të transportit të gurit gelqeror deri tek impianti i thyerjes së fraksionimit

- Gjenerim i një sasive pluhuri gjatë ngarkimit të transportit të gurit gelqeror, ndikim i cili do të jetë më i ndjeshëm në stinën e thatë
 - Gjenerim në ajër i sasive të caktuara të gazeve të lëndës plastike dhe djegies së naftes CO_x, NO_x dhe SO_x
 - Shqetësim i shtresave të tokës dhe ngjeshje e saj, vibrime, demtim i vegetacionit përreth karrieres
 - Ndotje e mundshme e tokës si pasojë e avarive të mekanikës, të cilat mund të bëhen shkak për rrjedhje të lubrifikantësh dhe karburantësh.
 - Ndotje e mundshme e ujërave sipërfaqësore dhe për shkak të shpëlarjes së mbetjeve nën veprimin e reshjeve.

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në biodiversitet.

- Shqetësim i mundshëm i faunës shkaktuar si pasojë e levizjes dhe zhurmave të njerezve dhe mjeteve në karriere, ndikim i cili është i perkohshëm.
- Demtim i vegetacionit ka të bëjë me ndikimin e pluhurit që krijohet gjatë punës në karriere, i cili ndikon në sjelljen e bimeve gjatë vegetacionit. Ky fakt nuk është vërejtur deri tani, por do të kihet parasysh nga subjekti KROMOLLARI gjatë monitorimit të aktivitetit.

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në toke.

Mund të kemi ndikime negative në tokë nga derdhja pa dashje e naftës dhe vajrave nga mjetet e punës e transportit në karriere. Behet fjalë për ndonjë rast të rrallë të rrjedhjes gjatë difekteve të tubave dhe sotokartit. Kujdes duhet të tregohet edhe gjatë ndërrimit të vajit të motorëve të mjeteve në karriere. Vaji i përdorur duhet të mbledhet në një fuci dhe është detyrim i subjektit KROMOLLARI për kontraktuar me një subjekt të licensuar që e grumbullon atë.

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në ajër

1. Mund të kemi ndikime negative në ajër nga shkarkimi i gazrave në sasi minimale, nga djegia jo e plotë e karburantit nga motorrat e makinerive në karriere. Kjo varet nga standarti i teknologjisë së prodhimit të mjeteve në uzinë dhe i cilesisë së karburantit.
2. Emetimi i zhurmave nga mjetet motorrike që punojnë në karriere. Edhe kjo varet nga standarti i teknologjisë së prodhimit të mjeteve në uzinë.

Prandaj në të dy rastet për eliminimin e ndikimeve negative në ajër duhet të behet nga subjekti kontroll i rregullt teknik dhe shërbime teknike të mjeteve sipas katalogut të uzinës prodhuese.

4.4 Ndikimet nderkufitare

Nuk ka, pasi kufiri shtetëror është larg nga objekti minerar.

4.5 Masat parandaluese për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis

Duke analizuar të gjithë faktorët që ndikojnë në mjedis shoqëria KROMOLLARI sh.p.k parashikon të marrë keto masa zbutëse për minimizimin apo dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, gjatë aktivitetit minerar të shfrytëzimit të gurit gelqeror si më poshtë:

- Gjatë shfrytëzimit të Karrierës ka prishje të pejsazhit natyror të sipërfaqes kryesisht shkembore dhe shumë pak e pyllëzuar, prandaj do të merren masa në vazhdimësi për rehabilitimin progresiv të saj. Keto masa planifikohen për të kryer një rehabilitim progresiv në vite dhe mbas mbarimit të shfrytëzimit në objektin minerar do kryhet rehabilitimi përfundimtar.
- Për këto qëllime do të behet taracimi dhe mbjellja e fidaneve në pjesën e shfrytëzuar të karrierës në zbatim të planit të Rehabilitimit të sipërfaqes së shfrytëzuar. Një kujdes i veçantë do të kushtohet evitimit në maksimum të erozionit duke ndërtuar kanale pritëse të ujërave sipërfaqësore të reshjeve atmosferike në pjesën me të sipërme të karrierës dhe në të dy anët e saj. Nepermjet pritave dhe kanaleve që do ndërtohen, do të behet disiplinimi i ujërave sipërfaqësore.
- Lenia e brezave mbrojtës dhe pyllëzimi i zonës përreth karrierës do të ndikojë në uljen e efekteve negative hapësimore dhe në territor për faunën e florën e zonës. Për këto do të ketë një bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor të Bashkisë Prrrenjas dhe kontribut konkret nga ana e firmës KROMOLLARI shpk.
- Nga drejtuesit e shoqërisë KROMOLLARI do të merren të gjitha masat e nevojshme për të rritur sigurinë në punë dhe mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve, të

manovratoreve te makinerive, duke bere ne vazhdimesi kontrollin teknik te mjeteve dhe riparimin e tyre sipas nje grafiku te percaktuar qe me pare teknikisht.

- Nga ana e subjektit KROMOLLARI sh.p.k duhet te behet ne vazhdimesi kombinimi i punimeve te shfrytezimit te karrieres me ato te zbutjes se impakteve mjedisore ne kete zone duke e bashkerenduar punen me autoritetet lokale Njesia administrative Rrajce e Sherbimi pyjor i Bashkise Prrenjas dhe Drejtorine Rajonale te Mjedisit ne ELBASAN.
- Gjithashtu duhet qe kujdesi per punimet rehabilituese progresive nga ana e ketij subjekti te vazhdoje pas mbarimit te punimeve te shfrytezimit te karrieres, sipas nje projekti te Rehabilitimit perfundimtar, i cili eshte hartuar nga vete subjekti per kete qellim.

4. 6 . Kohezgjatja e ndikimeve ne mjedisin e zones

- **Shtrirja fizike** - Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinore te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim, p.sh. ndikimi ne toke eshte nje ndikim saktesisht i percaktuar i cili mund te matet , por ne se do te zhvillohet erozion atehere ndikimi zhvendoset si ne permase fizike ashtu dhe te proçeseve dhe roleve tokesore.

Ndikimet negative gjate shfrytezimit te gurit gelqeror nuk do te kene shtrirje fizike jashte zones se dhene per shfrytezim. Nga subjekti KROMOLLARI do te merren masa per te mos patur erozion, duke disiplinuar ujerat siperfaqesore, duke rregulluar pjerresine e shkalleve te karrieres etj.

- **Kohezgjatja e ndikimit** - Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem). Ndersa te gjitha ndikimet e tjera negative ne mjedis jane te perkoshme, si shkarkimet e aluvjoneve, llumrave dhe ujit sipas veprave qe kryejne funksionet e procesit te prodhimit te gurit gelqeror.

Ndikimet do te jene te perkoheshme dhe me kohezgjatje deri sa te mbaroje shfrytezimi i nje blloku shfrytezimi te mineralit. Edhe shkarkimet e llumerave e alluvjoneve do te jene te perkoheshme, pra vetem ne ditet me reshje atmosferike dhe do te drejtohen te perfundojne ne gropat e dekantimit ne fund te karrieres.

- **Kthyeshmeria** - Vlereson mundesin e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te me pashme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar) .

Mbas mbarimit te shfrytezimit eshte detyrim i subjektit te pajisur me Leje minerare per te bere rehabilitimin e siperfaqes se shfrytezimit, e cila do te marri formen e nje gjysem amfiteatri te mbjelle me peme e bar.

- **Rendesia** - Realizon nje vleresim total te tre permasave te me siperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit ne mjedis, aspekte te cilat trajtohen ne Planin e menaxhimit.

Gjate realizimit te procesit teknologjik te shfrytezimit te gurit gelqeror , ndikimet ne mjedis nuk do kene shtrirje fizike, pra do te jene brenda siperfaqes se dhene per shfrytezim $S = 0.026 \text{ km}^2$. Gjithashtu kohezgjatja e ndikimit do te jete e perkoheshme, brenda afatit te shfrytezimit te bllokut te shfrytezimit te gurit gelqeror (zbulimi i gelqerorit prej mases dherore, funksionimi i gropave te dekantimit te ujrave te perdorura, punimet rehabilituese

etj.). Mjedisi mbas shfrytezimit te mineralit ne karriere do te rigjenerohet duke bere rehabilitimin e siperfaqes se shfrytezuar.

Pra duke bere nje vleresim total te ketyre tre permasave rezulton se ndikimet ne mjedis me nje administrim te mire te tyre nga subjekti KROMOLLARI, do te jene te perkoheshme, nuk do kene shtrirje fizike nga vendndodhja e objektit minerar dhe do te ruaje aftesine per tu rehabilituar e rigjeneruar.

Siperfaqja e shtrirjes se ndikimit ne mjedis

Shtrirja hapsinore e ndikimeve të aktivitetit minerar te shfrytezimit te gurit gelqeror është e kushtëzuar nga faktorë të tillë si, vendodhja e zonës së propozuar për zhvillimin e aktivitetit, vlerat biologjike të zones qe do shfrytezohet, teknologjia e projektit si dhe distanca nga zonat e banuara.

Shtrirja hapsinore e ndikimeve të parashikuara të veprimtarisë do të jetë e njëjtë me ato që janë ne kantiere ekzistuese perreth, brenda siperfaqes se dhene per shfrytezim.

5. MONITORIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE AKTIVITETIT MINERAR

Gjate shfrytezimit te gurit gelqeror ne siperfaqe nevojitet nje monitorim i vazhdueshem I te gjitha shkarkimeve ne toke, uje e ajer ne siperfaqen e objektit minerar- Leja Minerare 771/1, nga zoteruesi i lejes subjekti KROMOLLARI, per te gjithë ndikimet e mundeshme ne mjedisin rrethues.

Plani i monitorimit do te konsistoje ne :

- Monitorimi i parametrave gjeometrike te shkalleve te shfrytezimit si: pjerresi, lartesia, kendi i skarpates, pjerresia e sheshit te punes si dhe parametrave gjeometrike te parshikuar ne projekt. Monitorimi i sjelljes se formacioneve ne kufijte e jashtem te karrieres dhe marrja e masave per parandalimin e levizjeve te mundeshme si shkarje, shembje ose vithisje .
- Monitorimi i zones se mundeshme te shperndarjes se pluhurit gjate aktivitetit te shfrytezimit te gurit gelqeror ne siperfaqe. Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike te shperndarjes se pluhurit dhe marrja e masave perkatese te parashikuara ne projekt, per minimizimin e parandalimin e tij .
- Monitorimi i sjelljes se bimesise ekzistuese ne zonen per rreth karrieres dhe marrja e masave per parandalimin e demtimit te tyre. Monitorimi i siperfaqeve te mbushura me material dhe toke vegjetale gjate punimeve rehabilituese progresive, per parandalimin e shpellarjeve, gryerjeve, krijimin e gropave etj. Atje ku evidentohen demtime te kesaj zone duhet te merren masa per riparimin e tyre.
- Monitorimi i siperfaqeve te mbjella, pemeve dhe bimeve te kultivuara, ecurise normale te mbirjes dhe zhvillimit te tyre ne siperfaqen e shfrytezuara, per rehabilitimin normal te saj. Ne rastet kur verehet se ka demtime merren masa per zevendesime me fidane te rinj. Monitorimi i çdo siperfaqe te mbjelle do te vazhdoje per nje periudhe 4 vjeçare, kohe gjate se ciles bimet kane marre nje zhvillim te konsiderueshem dhe nuk kane me nevojë per sherbime.
- Monitorimi i sasise se gurit gelqeror te prodhuar ne karriere, sasia e karburantit dhe lubrifikanteve te perdorura per makinerite ne karriere, per transportin e mineralit dhe mbuleses gelqerore etj..

Subjekti KROMOLLARI shpk merr persiper sigurimin e ecurise normale te punes dhe ruajtjen e vazhdueshme te mjedisit deri ne mbylljen e aktivitetit. Subjekti gjithashtu do te mbaje lidhje te vazhdueshme me Drejtorine Rajonale te Mjedisit Elbasan, prane se ciles do te informoje periodikisht per mbarevajtjen e punes si gjate shfrytezimit ashtu dhe per monitorimn e parametrave te mesiperm.

6. KONKLUZIONE E REKOMANDIME

Objekti minerar i gelqeroreve “ Qaf Thane”, ndodhet 2.5 km mbi fshatin Urake, njesia administrative Rrajce, ne bashkine e Prrenjasit , Qarku Elbasan. Subjekti Kromollari zoteron Lejen minerare nr 771/1 per shfrytezimin e gurit gelqeror ne kete objekt minerar, per te cilin kerkohet Leja Mjedisore tipi B. Ne pjesen verilindore te objektit kalon rruga nacionale Tirane – Prrenjas – Pogradec, e cila nuk ndikohet nga aktiviteti i shfrytezimit te gurit gelqeror ne kete objekt minerar.

Vete terreni ku eshte dhene leja minerare eshte i aksidentuar dhe mjaft i shpelare nga erozioni dhe ne pjesen e poshteme te tij ka depozitime te konsiderueshme copezore te shkembinjve gelqerore. Siperfaqja e dhene per shfrytezim nuk eshte toke e kultivueshme, por toke kryesisht shkembore.

Vendburimi gelqeror ndodhet ne zonen e klimes mesdhetare kontinentale. Rreshjet vjetore zakonisht levizin nga 400 deri 1100 mm mesatarja vjetore 690 mm. Trashesia e debores ne disa raste ne maje arrin 40-50 cm. Ne zonen e vendburimit mungojne pothuajse teresisht pyjet, me perjashtim te disa shkurreve karakteristike si bushi, dellinjat, drizat, murrizi dhe shkure te tjera te ulta karakteristike te zones. Ne zonen e objektit kemi te bejme me nje terren te thate.

Sasia e rezervave te nxjesheshme te zones minerare te kerkuar eshte 591450 m³. Ecuria normale e shfrytezimit ben te detyrueshme kujdesin qe duhet te tregohet per ruajtjen e gjereseve te shesheve te punes dhe skarpatave te shkalleve si dhe lenien e shesheve te sigurise me futjen ne thellesi te karrieres. Gjate kryerjes se proceseve te shfrytezimit do ti kushtohet kujdes zbatimit te Rregullores se Teknikes se sigurimit ne Miniera dhe Karriera botim i vitit 2001. Nje problem tjeter eshte ruajtja e pjeresive te shesheve te punes per kullimin dhe sistemimin e ujrave te rrjeshjeve atmosferike . Shfrytezimi i objektit nuk ndryshon drejtimin natyral te rrjedhjes se ujrave, nuk ze toka buke dhe prish pyje dhe kullota.

Karakteristikat gjeomekanike te formacioneve qe ndertojne vendburimin bejne te nevojshme kryerjen e punimeve me lende plasese, te cilat nuk sjellin probleme ne mjedisin rrethues pasi zonat e banuara jane larg.

Duke bere nje analize te pergjithshme te te gjitha ndikimeve, negative e pozitive per objektin minerar “ Qaf Thane” – shfrytezim guri gelqeror ne afersi te fshatit Urake, ne njesine administrative Rrajce te Bashkise Prrenjas, per subjektin KROMOLLARI shpk, arrijme ne keto perfundime dhe rekomandojme dhe keto masa e konsiderata te pergjithshme :

- Zbatimi i projektit per hapjen dhe shfrytezimin e gurit gelqeror me karriere nuk do te kete ndonje pasoje negative te rendesishme dhe te nje natyre te pakthyeshme per mjedisin e zones. Shfrytezimi do behet duke rinovuar cdo vit planet vjetore te shfrytezimit ne AKBN Tirane dhe nen mbikqyrjen e vazhdueshme te Drejtuesit Teknik (Ing. miniere) te subjektit KROMOLLARI shpk .

- Ndikimi ne mjedis do te jete vetem ne ndryshimin e pejsazhit te zones qe do te jete i perkohshem, pasi me masat rehabilituese qe do te merren do te zbusin se tepermi kete fenomen, duke i mbjelle e kultivuar me bime dhe dru pyjore, te cilat jane te pershtatshem e te pranueshme per zonen perreth objektit minerar.
- Gjate gjithë aktivitetit te shfrytezimit te gurit gelqeror do te behet ne menyre periodike monitorimi i ndikimit ne cilesine e tokes, ujit e ajrit . Te aplikohet lagia e terreneve te punes (sprucimi me uje) dhe sidomos vendstokimet e gurit gelqeror, ne kohe te thate te periudhes se veres, per te minimizuar sasine e pluhurit, i cili ndikon ne vegjetacionin e bimesise perreth karrieres .
- Krahas rehabilitimit progresiv ne vite e rendesishme eshte marrja e masave per rehabilitimin e plote te zones mbas mbarimit te shfrytezimit, ne baze te Projektit te Rehabilitimit te hartuar per kete qellim nga subjekti KROMOLLARI shpk me specialiste te kesaj fushe.
- Kualifikimi i punonjesve ne perdorimin e makinerive ne karriere, ne zbatimin e rregullave te sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune, etj. do te ndikojne se tepermi ne ruajtjen e shendetit te punonjesve, duke ndikuar pozitivisht ne ecurine normale te punes per shfrytezimin e gurit gelqeror.
- Te merren masa per ndertimin e pritave dhe kanalizimin e disiplinimin e ujrave te shiut, ne menyre qe te mos ndikojne ne gerryerjen e shpelarjen e materialeve inerte brenda siperfaqes se dhene per shfrytezim. Te ndertohen gropa dekantimi sipas Projektit, per ujrat e ndotura gjate shpelarjes se materialit gelqeror nga reshjet atmosferike.
- Gjithashtu punesimi i nje numri te konsiderueshem punonjsish, prodhimi e tregetimi i inerteve me cmim me te ulet se deri tani, etj. do te ndikojne pozitivisht edhe ne zhvillimin e perparimin e kesaj zone qe ndodhet ne juridiksionin e Bashkise Prrenjas, Qarku Elbasan.

Hartuan **Permbledhjen joteknike te VNM se thelluar**

Shoqeria JOKLEN & CO

Eksperti i vleresimit te ndikimit ne mjedis

Ing. Demir Kullolli

